

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT KUKËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Këshillin e Qarkut Kukës me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 176, datë 28.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 1165/10 , datë 28.12.2012 , dërguar **z. Ipsen ELEZI**, Kryetar i Këshillit të Qarkut Kukës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1-Të merren masa të ndiqen procedurat e hapat ligjore nga Këshilli i Qarkut Kukës, duke kërkuar zbatimin e detyrës së lënë nga auditimi i mëparshëm, dhe arkëtimin e përfitimit të padrejtë nga 7 persona në dëm të buxhetit lokal me vlerë **222,848 lekë**.

Deri më Mars 2013

2-Të merren masa nga Këshilli i Qarkut Kukës, që të përgatisë raportin vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar e kontrollit për çdo vit, dhe t'i dërgojë në Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

Vazhdimisht

3-Të merren masa nga Këshilli i Qarkut Kukës, për të ngritur grupin e menaxhimit strategjik të njësisë publike dhe të miratojë strategjinë e riskut.

Menjëherë

4-Të merren masa nga Këshilli i Qarkut, për të hapur regjistrin e raportimeve (elektronik ose manual) dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

Menjëherë

5-Nga Këshilli i Qarkut Kukës, të përcaktohet struktura organike sipas kërkesave të lidhjes nr. 4, të VKM nr 1619, datë 02.07.2008, i ndryshuar, si dhe të kërkesave të VKM nr 474, datë 16.06.2011, duke e paraqitur për miratim në mbledhjen e radhës të këshillit.

Brenda Muajit Janar 2013

6-Të merren masa nga Këshilli i Qarkut Kukës, ku të përcaktohet dhe miratohet numri i punonjësve dhe niveli i pagave, në mënyrë nominale për çdo punonjës, mbështetur në arsimimin përkatës, vjetërsinë, grupin e diplomës, klasën e kategorisë së pagës, që i përgjigjet grupit të diplomës, kërkesa këto të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar.

Menjëherë

7- Të merren masa nga Këshilli i Qarkut Kukës, që të verifikojë të gjithë dokumentacionin arsimor, për të gjithë punonjësit të cilët janë në marrëdhënie pune me këtë institucion, dhe për mos përputhshmërinë e formimit arsimor me pozicionin e vendit të punës, pagesës përkatëse, të rrillogariten pagesat dhe për diferencat e rezultuara të ndiqen të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e tyre.

Brenda muajit Shkurt 2013

8-Të merren masa nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, që të kryhet përlllogaritja dhe pagesa e detyrimeve të lejeve të ndërtimit për 3 raste për vlerën 1,403,296 lekë.

Brenda muajit Mars 2013

9-Të merren masa nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, që në bashkëpunim me Autoritetet Vendore të Planifikimit, pranë njësive të qeverisjes vendore, për hartimin dhe miratimin e instrumenteve të planifikimit në nivel vendor dhe ndërvendor, si PZHNJV, Plani Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planifikimit për PPV, si detyrim ligjor për të gjitha njësitë vendore. Kjo do të hap rrugën zhvillimit të territorit në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim që shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit për planifikimin dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

11-Të merren masa nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të fillojë procesin e inventarizimit dhe të arkivimit, të dosjeve përkatëse të lejeve të ndërtimit dhe lejeve të shfrytëzimit, si dhe vendosjen e tyre në arkivin urban të Këshillit të Qarkut Kukës.

Menjëherë

12-Të merren masa, nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, që lejet e ndërtimit të miratuara para hyrjes në fuqi të ligjit të planifikimit të territorit dhe lejet e ndërtimit që janë në zbatim, të ndiqet zbatimin e tyre në përputhje me kushtet e lejes së dhënë.

Vazhdimisht

13-Të merren masa nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, që ndërtimet e përfunduara para hyrjes në fuqi me efekte të plota të ligjit për planifikimin e territorit, lejen e përdorimit (leja e shfrytëzimit) ta marrin në përputhje me kushtet e zbatimit të lejes së ndërtimit të miratuar.

Vazhdimisht

14-Të merren masa nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, që në aktivitetin e tyre të ushtrojë me përgjegjësi kompetencat e përcaktuara në ligjin për inspektimin e ndërtimit dhe në VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV”.

Vazhdimisht

15-Të merren masa nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për të evidentuar treguesit fizikë e kimikë të fondit të tokës dhe zonat e dëmtuara ose të rrezikuara nga dëmtimet fizike, erozioni, shkretëtirëzimi, degradimi dhe ndotja.

Vazhdimisht

16-Të merren masa nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për të kryer kontrolle mbi zbatimin e projekteve për shfrytëzimin e resurseve nga shoqëritë private, si dhe marrjen e masave administrative për këtë qëllim.

Vazhdimisht

17-Të merren masa nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për të marrë masa konkrete për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe shpalljen e zonave të tokave bujqësore në mbrojtje në territorin e qarkut.

Vazhdimisht

18-Të merren masa nga, Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës bujqësore, për të ushtruar funksionet e veta në lidhje me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, të parashikuar në ligjin nr. 9244, 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” neni 1 dhe VKM nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore” kreu IV.

Vazhdimisht

19-Të merren masa nga Komisioni i Mbrojtjes së Tokës, për të ushtruar funksionet e veta të parashikuar në ligjin nr. 9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, neni 8 dhe VKM nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore” kreu III.

Vazhdimisht

20-Të merren masa nga Këshilli i Qarkut, për të ndarë nga një strukturë përbashkët, në të veçanta, Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës bujqësore dhe Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohen në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën **5,411,395 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, në mënyrë analitike si më poshtë:

a. Për vlerën **2,183,574 lekë**, në ngarkim të punonjësve të mëposhtëm;

| | | |
|----|------------|--------------|
| 1. | ██████████ | 628,238 lekë |
| 2. | ██████████ | 628,238 lekë |
| 3. | ██████████ | 122,385 lekë |
| 4. | ██████████ | 530,610 lekë |
| 5. | ██████████ | 118,258 lekë |
| 6. | ██████████ | 43,795 lekë |
| 7. | ██████████ | 78,012 lekë |
| 8. | ██████████ | 34,038 lekë |

Për shkak se këta punonjës janë me arsim të mesëm dhe që punojnë në vende pune të shërbimit civil apo punonjës ndihmës dhe i është dhënë pagë për vjetërsi e pagë në pozicion të specialistit me arsim të lartë, së klasës së III, kategoria III-b, pagesa këto në kundërshtim me kërkesat e pikës 18, 19, 20/6 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar.

b. Për vlerën **2,277,061 lekë**, në ngarkim të punonjësve të mëposhtëm;

| | | |
|----|------------|--------------|
| 1. | ██████████ | 597,205 lekë |
| 2. | ██████████ | 980,070 lekë |
| 3. | ██████████ | 268,504 lekë |

4. [REDACTED] 155,230 lekë
5. [REDACTED] 214,480 lekë
6. [REDACTED] 61,572 lekë

Pasi këto pagesa janë dhënë në kundërshtim me pikën 15 të VKM nr. 434, datë 13.7.2007 dhe pikën 18, të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar dhe të lidhjes 3 e 7 të VKM nr. 693 datë 18.8.2010 dhe VKM nr. 553, datë 11.8.2011.

c. Për vlerën **950,760 lekë**, në ngarkim të punonjësve të mëposhtëm;

1. [REDACTED] 494,460 lekë
2. [REDACTED] 292,500 lekë
3. [REDACTED] 163,800 lekë

-për dhënie shpërblim si këshilltar çdo muaji kryetarit dhe zv/kryetarit në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar.

C-MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” neni 25 dhe VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Këshillit të Qarkut, që të analizojë rezultatet e auditimit sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të nxjerrë përgjegjësinë për secilin nga punonjësit e atakuar në këtë raport dhe të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masës disiplinore, për personat e rezultuar përgjegjës.

Për zotin [REDACTED] ish Kryetar i Këshillit të Qarkut Kukës, i cili aktualisht nuk është punonjës në këtë institucion, për përgjegjësinë që ka për shkeljet e konstatuara gjatë kryerjes së kësaj detyre do të rekomandonim masën disiplinore shkarkim nga detyra, pasi ka qenë i zgjedhur, në kushtet e ndodhura nuk krijohet mundësia për dhënie mase disiplinore.

Për zotin [REDACTED], ish drejtor i Burimeve Njerëzore për përgjegjësinë e në kryerjen e detyrës do të rekomandonim masën “Largim nga Shërbimi Civil” për shkelje të rënda me pasoja negative në buxhetin e shtetit, dhe mos qenia në marrëdhënie pune, nuk krijon mundësi për dhënie mase tjetër disiplinore.

Për këtë nga Këshilli i Qarkut Kukës të dërgohet shkresa në Departamentin e Administratës Publike, për të kryer rregjistrimet përkatëse të masës “Largim nga Shërbimi Civil”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bajram Lamaj, Ramadan Zejnuni, Xhevdet Haxhiu dhe Julian Adili. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT